

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika® Injection-306

RRËSHIRË INJEKTIMI ELASTIKE POLIAKRILIKE PËR HIDROIZOLIM TË PËRHERSHËM

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® Injection-306 është rrëshirë injektimi elastike poliakrilike me viskozitet të ulët dhe me kohë reaksioni të adaptueshme.

PËRDORIMET

- Sika® Injection-306 duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë.
- Sika® Injection-306 përdoret për riparimin me anë të injektimit të membranave hidroizoluese që janë dëmtuar (sistem me 1 dhe 2 shtresa).
 - Sika® Injection-306 përdoret si një sistem izolimi të jashtëm post-konstruksioni për fugat e ndërtimit dhe fugat me përhapje të kufizuar lëvizjeje ose fugat e tubave të drenazhimit, që janë ose që do të, mbulohen me dhë të lagësht ose të ngopur me ujë.
 - Sika® Injection-306 përdoret për injektimin e tubave për injektim SikaFuko® për izolimin e fugave të ndërtimit.
 - Sika® Injection-306 mund të përdoret për izolimin e plasaritjeve dhe zgavrave me përmbajtje uji.
 - Sika® Injection-306 mund të përdoret për krijimin e mureve të rinj izolues (mantele) në kushte me dhë të lagësht ose të ngopur me ujë, që ndodhen në afërsi të ndërtesës ose brenda strukturës së ndërtesës.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Kohë e adaptueshme tharjeje midis 8 dhe 50 minutash
- Elasticitet i përherëshëm, mund të përthithë lëvizje të kufizuara
- Mundësi përthithjeje (bymim) dhe çlirimi (tkurrje) të lagështisë
- Rrëshirë akrilike pa tretës
- Vlerë e lartë pH nga 9 deri në 10
- Viskozitet shumë i ulët në krahasim me atë të ujit
- Sika® Injection-306 i tharë është i patretshëm në ujë dhe hidrokarbure dhe rezistent ndaj acideve dhe alkaleve
- Mund të përdoret në zonat e mbrojtjes së ujërave nëntokësore

MIRATIME / STANDARDE

- Wissbau No. 2002-094-(1A) – Test funksionimi me SikaFuko® VT 1
- Wissbau No. 2002-094-(2A) – Test funksionimi me SikaFuko® Eco 1
- FH Aachen – ekspertizë, stabilitet mekanik afatgjatë – 01/11/2016
- MPA TU Braunschweig No. 1200/550/15b – Test kompatibiliteti me membranat Sikaplan WP/WT 03/02/2016

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Rrëshirë poliakrilike me 3 përbërës	
Ambalazhi	Përbërësi A (rrëshira)	2 × 8.0 kg
	Akseleratori	1 × 1.0 kg
	Pluhur forcuesi	4 × 40 g
	Gota e matjes	1 copë
Akselerator shtesë 4 x 1 kg - përdoret për kohë reaksioni më të shpejta		

Ngjyra	Përbërësi A (rrëshira)	blu – transparent
	Akseleratori	i verdhë – transparent
	Pluhur forcuesi	i bardhë
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar.	
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në kushte të thata dhe temperatura midis +10 °C dhe +30 °C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe lagështia.	
Viskoziteti	~3-11 mPa·s (miks, në 20 °C)	(sipas ISO 3219)

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes	Solucion akseleratori	Akselerator : Ujë	ndryshon, shih Tabelën e matjes më poshtë
	APremix	Solucion akseleratori : Përbërësi A (rrëshira)	2 L për 8 kg Përbërësi A (rrëshira)
	BHardener Solution	Pluhur forcuesi : Ujë	80 g (2 × 40 g) për 10 L ujë
	Sika® Injection-306	APremix : BHardener Solution	1 : 1 për vëllim

Shënim për përpunimin në pompat 1 komponentëshe:

Koha e punueshmërisë (pot life) = Koha e reaksionit (shih tabelën e matjes) – 10 minuta

Tabela e matjes së akseleratorit

ml akseleratori ¹	Temperatura e ambientit				
Koha e reaksionit	5 °C (41 °F)	10 °C (50 °F)	20 °C (68 °F)	30 °C (86 °F)	40 °C (104 °F)
8 min			2000 ²	980 ²	380
10 min			1150 ²	480	240
12 min		1880 ²	820 ²	320	180
15 min	1800 ²	1240 ²	480	220	100
20 min	1060 ²	900 ²	280	140	60
25 min	820 ²	480	200	80	
30 min	620 ²	350	160		
35 min	440	280	120		
40 min	360	250	80		
45 min	320	220	78		
50 min	250	200	74		

- Sasia e akseleratorit për 8 kg përbërës A, prodhon 20 litra kg rrëshirë të përzjerë (solucioni total i akseleratorit duhet të jetë 2000 ml 2 litra – shih shëmbullin më poshtë).
- Reaksion i shpejtë – nevojitet akselerator shtesë.

Shëmbull:

Temperatura e ambientit: 10 °C (50 °F)

Koha e kërkuar e reaksionit: 25 min

Akselerator në ml = 480 ml

Ujë në ml = 1520 ml

Vëllimi total = 2000 ml

Shënim:

Vlerat e dhëna janë parametra laboratorit dhe mund të ndryshojnë në varësi të objektit dhe kushteve në kantier.

Temperatura e mjedisit	+5 °C min. / +40 °C max
Temperatura e nënshtresës	+5 °C min. / +40 °C max.
Koha e maturimit	8 deri në 50 minuta

UDHËZIME APLIKIMI

PËRZIERJA

1. Tretni përmbajtjen e 2 qeseve të pluhurit të forcuesit në 10 litra uji në një konteiner të pastër. Përzieri solucionin e forcuesit derisa pluhuri i forcuesit të jetë tretur plotësisht.
2. Përcaktoni sasinë e kërkuar të akseleratorit nga tabela e matjes së akseleratorit (raporti i përzierjes), duke patur parasysh temperaturën e ambientit dhe kohën e kërkuar të reaksionit. Holloni sasinë e përzgjedhur të akseleratorit me ujë në sasi totale deri në 2 lt në një konteiner të pastër.
3. Hidhni 2 lt solucion akseleratori brenda bidonit 8 kg të përbërësit A (rrëshira) dhe përzieri duke tundur bidonin.

Rrëshira për injektim aktivizohet në varësi të llojit të pompës së injektimit që do të përdoret:

- Kur përdoret pompë 1 komponentëshe: Hidhni një sasi të pjesshme të përbërësve të përzierë paraprakisht në raport 1:1 për vëllim brenda një konteineri të pastër për përzierje dhe përzieri mekanikisht.
- Kur përdoret pompë 2 komponentëshe: Mbushni konteinerin e pompës me sasi të pjesshme të përbërësve të përzierë. Vendosni pompën në punë në raport përzierjeje 1:1 për vëllim.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Sika® Injection-306 mund të përpunohet me pompë standarde 1 ose 2 komponentëshe. Rekomandohen pompa injektimi prej çeliku të pandryshkshëm.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit sipas skedës teknike për pastrimin e sistemit Sika® Injection.

KUFIZIME

- Përpara krijimit të shtresës së re sipërfaqësore hidroizoluese, në afërsi të ndërtesave ose brenda strukturave ekzistuese, duhet të inspektohen & survejohen kushtet e aplikimit në kantier, duke përfshirë çdo themel dhe kushtet e tokës. Gjithashtu, duhet të sigurohet se nuk ekzistojnë sisteme drenazhimi ose tuba të hapur pranë zonës së injektimit.
- Kjo skedë teknike jep informacione për vlerësimin e fizibilitetit të propozimit për injektim & konsumimin e vlerësuar të materialit. Kjo gjë përcakton edhe pozicionet për shpimin e vrimave të injektimit.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika® Injection-306

Shkurt 2019, Botimi 02.01

020707020030000001

SikaInjection-306-sq-AL-(02-2019)-2-1.pdf